



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 16709 Prot

Shkodër, më 13.11 .2023

Lënda: Dërgohet projekt- vendim dhe relacion

KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

“Për miratimin e dhurimit të impiantit fotovoltaik i cili do të vendoset pranë shkollës” kol idromeno” dhe dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkepunimit ndërmjet subjektit “Euroelektra” shpk dhe përfituesit bashkia Shkodër “

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

KRYETAR

Opid BEJLERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

PROJEKT - VENDIM

Nr._____, datë_____.____.2023

“PËR MIRATIMIN E DHURIMIT TË IMPIANTIT FOTOVOLTAIK I CILI DO TË VENDOSSET PRANË SHKOLLËS” KOL IDROMENO” DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKEPUNIMIT NDËRMJET SUBJEKTIT “EUROELEKTRA” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA SHKODËR”

Keshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e tij të datës ___/___ 2023, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; Ligjit nr 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme; Ligjit nr 107/2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit“ të ndryshuar; VKM nr.408, datë 13.05.2015 ”Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit“ të ndryshuar; VKM Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës Përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar; Vertetim Hipotekor nr.489 dt.08.01.2028; Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik” i ndryshuar si dhe relacionit të administratës së bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhurimin, impiantit fotovoltaik i cili do të vendoset pranë shkollës “ Kol Idromeno” dhe dhëniën e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet subjektit “Euroelektra” shpk dhe përfituesit bashkia Shkodër”
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Benet BECI

VENDIM DELEGIM

Z/KRYETARI

Onid BEJLERI



Zv/Kryetar

Orion Bejler

Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave

Arta Stelaj
AS

Drejtoria Juridike

Budesa Dedej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

**RELACION
PER**

“PËR MIRATIMIN E DHURIMIT TË IMPIANTIT FOTOVOLTAIK I CILI DO TË VENDOSSET PRANË SHKOLLËS” KOL IDROMENO” DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKEPUNIMIT NDËRMJET SUBJEKTIT “EUROELEKTRA” SHPK DHE PËRFITUESIT BASHKIA SHKODËR”

Një nga strategjitë kryesore të bashkisë është “tranzicioni i gjelbër” , kjo strategji gjithëpërfshirëse do të kontribuojë në kursimin e energjisë, rritjen e përdorimit të burimeve të energjisë diellore, erës, hidroenergjisë dhe reduktimin e CO2.

Një nga objektivat e kësaj strategjie është edhe Adresimi i sfidës se efijencës së energjisë nëpërmjet përdorimit të burimeve të mëdha të energjisë së rinovueshme duke ofruar përmirësime të Eficiences se Energjisë në përgjithësi për të gjitha shërbimet e drejtpërdrejta bashkiake (ndërtesat dhe shërbimet publike), si dhe të gjithë sektorët indirect si sektori rezidencial, turizmi, shërbimi privat dhe tregtar, industria, bujqësia dhe transporti privat.

Kjo strategji e bashkisë është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Energji dhe Klimë 2020-2030 e miratuar me VKM nr 872/2021. Ky dokument parashtron kontributin e të gjithëve duke përfshirë edhe Bashkitë të kontribuojnë në objektivat kombëtare: kursim në emetimet e GS-ve prej 18.7%, ulje të konsumit final të energjisë me 8.4% dhe energji të rinovueshme.

Promovimi i këtyre politikave/strategjive dhe objektive të Bashkisë Shkodër ka sjellë edhe ndjeshmërinë e subjekteve të ndryshme për ofrimin e shërbimeve të tyre në zbatimin e këtyre objektiveve.

Kështu subjekti “Euro Elektra” shpk ka paraqitur pranë bashkisë Shkodër kërkesën për “ Instalimin e një impianti fotovoltaik “ në shkolla e mesme “ Kol Idromeno” në qytetin e Shkodrës.

Objekti i Shkollës së Mesme “ Kol Idromeno” është pronë e Bashkisë Shkodër kjo bazuar në “ Vërtetimin nga dokumenti hipotekor” nr 8/99 pasurie ndodhur në Zonën Kadastrale 8594 sipërfaqe trualli 5841 m2 prej të cilave 740 m4 ndërtim 4 kat (bashkëlidhur)

Për këtë investim do të përdoret tarraca e objektit në të cilën do të vendosen 46 module me një sipërfaqe prej 2.4 m2 sejcili dhe fuqia e instaluar e të cilave do të jetë 20.24 kWp . Modulet jane

panele SunPowr-MAXEON, të cilët janë të njohur për energjine e prodhuar dhe avantazhet në kombinimin e fuqisë së prodhuar dhe kursimit të saj.

Garancia e produktit është 25 vjet dhe pas 25 vitesh garanci performace 92%.

Impianti fotovoltaik do të prodhojë energji elektrike përmes energjisë diellore. Kjo energji që do të prodhohet nga ky impiant do të përdoret nga bashkia me qëllim uljen e konsumit të saj nga rrjeti i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike duke kursyer kështu faturat e saj të energjisë elektrike.

Njëkohësisht sasia e tepert e energjisë së prodhuar e cila do injektohet në rrjetin kombëtar të OSHEE. Bashkia do të llojë me OSSHE që sasia e tepert e energjisë, pra çdo njësi këh e prodhuar të mund të zbritet nga konsumi i energjisë për objektet e tjera publike. Kjo deri në momentin e daljes së akteve nënligjore të cilat rregullojnë këtë marrëdhënie.

Subjekti EuroElektra është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 2010 Portofoli i kësaj kompanie mbulon edhe sektorë të rëndësishëm si: Ndrimi profesional LED Eficenca energjitime, Automatizimi i shtëpisë dhe godinës (Smart Building) si edhe Energjia e Rinovueshme.

Kompania ka realizuar një numër të konsiderueshëm projektesh në sektorin fotovoltaik si për konsumator familjar ashtu edhe për biznese. Kështu ka realizuar mbi 30 projekte për impiante fotovoltaike për sublekte të ndryshme industriale po ashtu edhe familjare. Një prej tyre është edhe impianti fotovoltaik në qendrën e vizitorëve në Theth.


Në kuadër të kësaj kërkesë për sponsorizim është realizuar një draft marrëveshje (bashkëlidhur) ku përcaktohen qartë detyrimet dhe të drejtat për sejcilën palë.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme, Ligjit nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar; VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të territorit” të ndryshuar; VKM Nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës Përfundimtare (të pjeshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” të ndryshuar; Vertetim Hipotekor nr.489 dt.08.01.2028; Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”

Ju ftojme në miratimin për dhënie e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes së sponsorizimit

Drejtoria e mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujrave

Aida Shllaku



KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z. KRYETAR

Onid BEJLERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Bashkia Shkodër

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . 2023



Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . 2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
INSTALIM IMPIANT FOTOVOLTAIK SHKOLLA E MESME
“ KOLË IDROMENO”, BASHKIA SHKODËR.

- **DHURUES:** EUROELEKTRA shpk, e regjistruar si person juridik me numër unik identifikimi L01808013Q, me seli në adresën: Rruga Prush 1041, Vaqar Tiranë, e përfaqësuar nga administratori **z.Elton ÇEKREZI**, identifikuar me letërnjoftim ID me numër personal 151103046R;
- **PËRFITUES I DHURIMIT:** BASHKIA SHKODËR, me numër unik identifikimi K36813001H, me seli në adresën: Rruga 13 Dhjetori, Nd.9, H1, Shkodër, 4001, e përfaqësuar nga Kryetari **z.Benet BECI**, identifikuar me letërnjoftim ID me numër personal _____;

Baza Ligjore: Kjo marrëveshje nëshkruhet në mbështetje të ligjit nr.7850, datë 27.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar ;

Meqënëse, në lidhjen e kësaj marrëveshje ekziston pëlqimi i të 2 (dy) palëve për marrjen përsipër të detyrimëve/angazhimeve përkatëse, ekziston shkaku i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet dhe objekti që formon lëndën e saj, palët me vullnet të lirë bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1. Objekti i marrëveshjes

- 1.1 Kjo Marrëveshje ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve, përcaktimin e angazhimeve të ndërsjellta ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe shoqërisë EuroElektra shpk, në zbatimin e projektit të përbashkët, instalimi i një impianti fotovoltaik (*prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore*) mbi ndërtesën e **Shkolla e Mesme 'Kolë Idromeno'**, me vendndodhje në Bulevardi Mehmet Pashë Plaku, Bashkia Shkodër.
- 1.2 Energjia elektrike që do të prodhohet nga ky impiant do të përdoret nga Bashkia Shkodër me qëllim uljen e konsumit të saj nga rrjeti publik i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) duke kursyer kështu në faturat e saj të energjisë elektrike. Ekuivalenca në lekë e sasisë së energjisë së prodhuar dhe në të njëjtën kohë të kursyer nga Bashkia në një vit, do të vihet në dispozicion të nevojave të shkollës 'Kolë Idromeno', bazuar në një projekt-ide të

marrëveshje të “matjes neto” të energjisë, e cila bën të mundur që çdo njësi (kWh) energjie elektrike që do të injektohet në rrjetin publik të OSHEE do t’i njihet Bashkisë Shkodër dhe do t’i zbritet nga konsumi i saj në pika të ndryshme.

- 3.3.2 Nëse nuk do të arrihet marrëveshja e mësipërme, mbiprodhimi i energjisë i krijuar për shkak të energjisë që nuk do të konsumohet nga shkolla, do të transferohet falas në rrjet në favor të OSHEE.
- 3.3.3 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e angazhimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e projektit dhe të realizimit me sukses të tij.

Neni 4. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 4.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve, dhe që ka të bëjë për shembull me vlefshmërinë, interpretimin, ekzekutimin, përfundimin etj., zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt Palët i drejtohen Gjykatës Kompetente, për zgjidhjen e tyre.

Neni 5. Dispozita të Tjera

- 5.1 Çdo ndryshim apo modifikim i marrëveshjes, për shkak të sugjerimeve apo shtesave, ato do të jenë të vlefshme vetëm pasi të jetë bënë me shkrim dhe të jenë nënshkruar nga të 2 (dy) Palët.
- 5.2 Për çështje të tjera që mund të lindin gjatë zbatimit të saj dhe që nuk parashikohen në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe dispozitat e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
- 5.3 Kjo marrëveshje bashkëpunimi është hartuar në 4 (katër) njësi origjinale, nga 2 (dy) për secilën Palë.

PALËT

BASHKIA SHKODËR
KRYETARI
BENET BECI

EUROELEKTRA SHPK
ADMINISTRATORI
ELTON ÇEKREZI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E RREGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
RRETHI SHKODER

VERTETIM
NGA DOKUMENTI HIPOTEKOR

Vertetohet se ne regjistrin hipotekor me nr. 489
 Datë 24/12/2013, figuron e regjistruar ne pronesi te:

Emri	Atesia	Mbiemri	Pjesa
<u>BASHKIA</u>	<u>SHKODËR</u>		<u>I</u>
/	/	/	/
/	/	/	/
/	/	/	/
/	/	/	/
/	/	/	/
/	/	/	/
/	/	/	/

Pasuria me nr. 8/99 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8594 me
 Siperfaqe 5841 m², ne adresen SHKODËR
(PESËHTJË E TETËQIND E DYZET E NJË) m² TRUALL NGA TË CILAT 740 m² NDËRTESE
4 KAT (SHTATËQIND E DYZET) m²
 Kufizimet e pasurise jane:
 V 8/121, 135 L 8/73, 76
 J 8/78 P 8/96

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajtshme:
 Nr. hip _____, date: ___/___/___ nr. hip. _____, date ___/___/___
 Nr. hip _____, date: ___/___/___ nr. hip. _____, date ___/___/___
 Nr. hip _____, date: ___/___/___ nr. hip. _____, date ___/___/___

Barre mbi pasurine: NUK KA

Komente nga regjistruesi: NUK KA


Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harte Treguese Provizore

Zyra e Regjistrimit nuk garanton vertetimin e pronesise perpara perfundimit te Regjistrimit Fillestar sipas ligjit Nr. 33, date 21.03.2012

Vertetimi i pronesise leshohet sipas kerkeses Nr. 185
 Date 08/01/2018 regjistruar ne ZRPP

Date: 08/01/2018

[Signature]



[Handwritten notes and signatures]

